



Komuna e Klinës
Kryetari i Komunës
01Nr.610-30164/2023
Klinë, datë 30/08/2023

*Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, publikuar në gazetën zyrtare, me dt. 04.06.2008 nr.28, në nenit 91 paragrafi 1 i Statutit të Komunës së Klinës, të dt.07.04.2010, në nenin 2 pika 2.3 dhe nenin 4 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, nr. 03/L-49, duke marrë parasysh dispozitat e nenit 5 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve, nr.06-4043/2015, kërkesën, nr.01-610-30164/2023 të dt.29.08.2023 të parashtruar nga OJQ "Forumi Ekonomik Rajonal Dukagjini", memorandumit e bashkëpunimit nr.01-644-21622/2023 të datës 03.07.2023, si dhe Rekomandimin e DKA-së nr.01-610-30162/2023 të datës 29.08.2023, Kryetari i Komunës së Klinës, **mori, këtë;***

V E N D I M

1. **APROVOHËT**, në shumën prej **2,000.00 €** (dymijë euro) kërkesa, nr.01-610-30164/2023 e datës 29.08.2023 e parashtruar nga OJQ Forumi Ekonomik Rajonal "Dukagjini" më seli në Pejë më përfaqësues Luan Lulaj. Mjetet në vlerë prej **2,000.00 €** paguhet nga subvencionet e zyrës së kryetarit të komunës.
2. Kërkesa aprovet mbi bazën e memorandumit të bashkëpunimit të lidhur në mes të Komunës së Klinës dhe Universitetit të Pejës "Haxhi Zeka" më qëllim të organizimit të konferencës vjetore të forumit, për zhvillim ekonomik, akademik të rajonit.
3. Mjetet si nga pika 1 e këtij vendimi derdhen në xhironlogari të OJQ FER-"Dukagjini".
4. Për ekzekutimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit në bashkëpunim më Zyrën e Kryetarit dhe Drejtorinë e Arsimit.
5. Obligohet përfaqësuesi/ja e OJQ-së se lartpërmendur, që lidhur më mjetet e ndara Komunës së Klinës t'ia paraqes Raportin kthyes të shpenzimeve.
6. Pjese përbërëse e këtij vendimi janë: kërkesa, nr.01-610-30164/2023 e datës 29.08.2023, Rekomandimi për mbështetje financiare i DKA-së, i datës 29.08.2023, Memorandumi i Bashkëpunimit, nr.01-64421622/2023, si dhe dokumentacioni tjetër mbështetës.
7. Ky vendim është i plotëfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- Drejtoria e Financave;
- Përfaqësuesi i FER-D,
- DKA, si dhe;
- Arkivi.

Kryetari,
per Zenun Elezaj